

KRIZA ENERGETIKE NË EVROPË – NDIKIMI GJEOPOLITIK I “NORD
STREAM II” NË BASHKIMIN EVROPIAN

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË SHKENCA POLITIKE - INTEGRIME EVROPIANE
DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

NGA

IBRAHIM SALIHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE

PRISHTINË, SHTATOR 2022

REZYME

“KRIZA ENERGJETIKE NË EVROPË – NDIKIMI GJEOPOLITIK I “NORD STREAM II” NË BASHKIMIN EVROPIAN“

Mentori: Prof. Asoc. Dr Bardhok Bashota

Qëllim kryesorë i kësaj teme, është që të jetë një kontribut shtesë dhe një pikë reference në fushën akademike mbi krizën energjetike të Bashkimit Evropian. Sot, kjo është një ndër temat më të diskutuar në rrafshin politik dhe akademik, sa që ka ndikuar seriozisht në narracionin e politikbërjes të vendeve anëtare të BE-së dhe ndikuar në strategjitë ekonomike të tyre. Interesimi im për këtë temë filloi me ngjarjet aktuale të invadimit rus ndaj Ukrainës dhe marrëdhëniet e acaruar Perëndim – Lindje. Ku, pamjaftueshmëria e resurseve vetanake dhe pamundësia e gjetjes së ndonjë alternative tjetër për të siguruar gazin natyror, ka rritur shumë ndikimin e Rusisë mbi Evropën. Kjo varësi ekonomike e shteteve të BE-së, e posaçërisht e Gjermanisë, rrjedhimisht krijoi edhe varësinë gjeopolitike, që është theksi kryesorë i kësaj teme.

Baza e ndërtimit të kësaj teme masteri është e bazuar në shkollë teorike ndërkombëtare neo-realiste, pasi që kjo teorike jep një pasqyrë të qartë mbi ndikimin gjeopolitik dhe bashkëpunimin Gjermani- Rusi.

Supozimi i parë i realizmit është ekzistenca e anarkisë ndërkombëtare, ku shteti është i vetmi aktori kryesorë i cili mund të kujdeset për sigurinë e shtetit dhe të mbrojë interesat e veta politike dhe ekonomike. Së dyti, neo-realistët theksojnë se numri i lartë i shteteve është kërcënim seriozë, pasi që jo të gjitha janë të barabarta, ku me pas luan rolë fuqia në terma realist, që është e kufizuar në forca ushtarake dhe ekonomike. Së fundi, neorealizmi siguron që shtetet janë aktorë racionalë, të cilët thjesht shqetësohen për maksimizimin e mirëqenies së tyre. Lidhur me rastin e Nord Stream nga ky këndvështrim neoralist, mund të supozohet se preferencat e shtetit përcaktohen nga pozicioni i tyre gjeopolitik si dhe nga madhësia e tyre ekonomike. Rrjedhimisht, do të supozohej se çdo shtet promovon pozicionin më të favorshëm për interesat e tij, duke nënkuptuar një koordinim të politikave

Punimi është realizuar brenda intervalit kohor Janar-Shtator 2022. Në aspektin strukturor, teza e Masterit është e përbërë nga gjithsej 69 faqe, e ndarë në 6 kapituj dhe në disa nënkapituj të cilëve u paraprijnë: abstrakti, hyrja dhe metodologjia e punimit, ku shpjegohen qëllimet dhe metodat, pyetja hulumtuese, nën pyetjet hulumtuese dhe hipotezat të cilat janë përdorur. Çdo kapitull trajtohet si një njësi e veçantë, të cilët trajtojnë tema të veçanta të ndërlidhura me temën duke sqaruar më në detaje, bazën kryesore të temës. Gjithashtu ky punim në fund përmban konkluzionet si dhe burimet dhe literatura e shfrytëzuar për realizimin sa më objektiv të punimit.

PËRBËRJA/ARKITEKTURA E PUNIMIT

Në pjesën e hyrëse të punimit të tezës së Masterit parashtrohet abstrakti dhe hyrja e punimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit, struktura e punimit si dhe metodat, mjetet dhe teknikat që do të përdoren për të realizuar këtë hulumtim, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të asaj që synohet të trajtohet apo shtjellohet në këtë studim.

- I. **Kapitulli i parë [I]: –** “Sfondi teorik dhe historik i sjelljes së shteteve evropiane dhe interesave të tyre për çështje energjetike” – ky kapitull shtjellohet mbi dritën e marrëdhënieve energjetike Bashkim Evropian- Rusi, se si këto marrëdhënie qëndronin edhe para ekzistencës së rrjetit gaz sjellës Nord Stream dhe po ashtu sqarohet mungesa e vullnetit të shteteve anëtare të BE-së për një politikë të përbashkët mbi energjinë, që do të sillte implikime në të ardhmen në implementimin e Nord Stream II.

- II. **Kapitulli i dytë [II]: –** “Sfondi marrëdhënieve energjetike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ruisë” – Energjia si termë për Bashkimin Evropian gjithmonë ka qenë një utopi. Që nga filltet e para Bashkimi Evropian ishte e fokusuar për të gjetur një siguri brenda territorit të vetë dhe nuk pati në agjendën e saj evropiane energjinë. Mungesa e një politikë të tillë, do të jetë një pikë me ndikim brenda shteteve për mos marrëveshje në të ardhmen, ku ky nocion sqarohet në këtë kapitull.

- III. **Kapitulli i tretë [III]: – “Debatet brenda Bashkimit Evropian lidhur me Nord Stream II”** – është titulli i kapitullit të tretë të temës. Përderisa projekti Nord Stream ishte duke u zhvilluar, ai përgjatë rrugës hasi në pengesa dhe kundërshti të vendeve Evropiane. Shtete si Suedia, Danimarka dhe Letonia sollën pengesa për të implemtuar projektin, pasi që shtrirja e Nord Stream II ishte përgjatë territorit ujor të këtyre vendeve. Kundërshtive të tilla ju bashkëngjiten edhe SHBA të cilat kishin interesi mos ndikimin Rus në Evropë.
- IV. **Kapitulli i katërt [IV]: – “Përputhshmëria e Nord Stream II me legjislacionin evropian të energjisë”** – Në këtë kapitull, sqarohet aspekti ligjor i Nord Stream II, i cili hasi në pengesa të mëdha. Ku projekti është dashur që të jetë në përputhje me legjislacionin evropian të energjisë. Projekti po ashtu pati edhe probleme gjyqësore, nga e cila më e famshmja është çështja “C-848/19P”. Ku në këtë kontekst gjyqësor është Gjermani kundër Polonisë të cilat ndanin mendime të ndryshme për projektin Nord Stream II.
- V. **Kapitulli i pestë [V]: – “Ndikimi gjeopolitik i Nord Stream II në Evropë ”** – Ky kapitull është epiqendra e këtij punimi. Ku sqarohet se deri në çfarë mase arriti të shtrihet ndikimi gjeopolitik i Ruisë përmes Nord Stream II në Evropë, e me theks të veçantë në Gjermani. Mirëpo ky projekti përpos ndikimit gjeopolitik, sjelli ndërlikime edhe ekonomike edhe për Gjermaninë, e cila është duke hasur problem për të gjetur burim alternativë të energjisë. Ndikimi ekonomik u shtri edhe në disa vende të cilat u si Ukraina, Polonia dhe shtetet baltike, ku në këtë kapitull sqarohet në detaje për secilin vend veç e veç.
- VI. **Kapitulli i gjashtë [VI]: - “Pezullimi i Nord Stream II dhe tendenca për gjetjen e burimeve alternative”**

Sfidat ligjore nuk ishin të vetmet ato të cilat ngadalësuan implementimin e projektit Nord Stream II. Përderisa agresioni rus në territorin e Ukrainës ndryshoi gjithë terrenin politik duke vendosur sanksione ndaj Ruisë. Sanksionet të njëpasnjëshme nga shtetet evropiane edhe SHBA-të, bënë që Gjermania të tejkalojë interesat kombëtare për furnizim me gazin rusë dhe të pezullojë certifikimin e nisjes së punës të Nord Stream II. Pezullimi i projektit

Nord Stream II, obligoi qeverinë gjermane të shqyrtojë mundësit alternative për të gjetur burime të reja furnizuese. Ku në këtë kapitull janë të listuar disa nga burimet alternative të cilat mund të përdoren për të siguruar energji.

- VII. **[Përfundimet dhe Konkluzionet]** – ofrojnë një përmbledhje dhe një analizë të detajuar për këtë temë, duke vendosur theksin mbi të ardhmen e furnizimit me gaz të Gjermanisë. Përfundimet pas analizimit të projektit Nord Stream II, nga secili këndvështrim ndikues, ju përgjigjen pyetjeve hulumtuese dhe për të vërtetuar hipotezat e studimit, të cilat janë ngritur në fillim të punimit. Me fjalë të tjera përfundimet dhe konkluzionet e këtij studimi do të paraqesin atë që është arritur me këtë punim diplome.

Në fund të punimit, do të jetë e paraqitur '*Bibliografia dhe Literatura*', ku gjinden burimet kryesore, që do të përbëjnë një ndër shtyllat më të forta të këtij studimi, prandaj i është kushtuar një rendësi e veçantë përzgjedhjes së burimeve dhe filtrimit të tyre.